



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1344/4 prot

Datë 12.05.2026

V E N D I M
Nr. 628/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83467-04-27-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i ndërveprimit me e-albania” për Bashkinë Krujë”, me fondi limit 1,666,000.00 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 08.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje

Ankimues: Operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK me NIPT M38106801F dhe adresë: BARAJ 01960008 Nd. 64, H. 1., Mallakastër

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kruje me adresë: Kruje Qender, sheshi “Mustafa Merlika (Kruja)”

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik”.

I.2. Operatori ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.04.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83467-04-27-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i ndërveprimit me e-albania” për Bashkinë Krujë”, me fondi limit 1,666,000.00 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 08.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.

II.2. Në datën 30.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6601 dhe me nr. 1344/2026 prot., datë 30.04.2026, e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 3379 prot., datë 06.05.2026 me lëndë: “Njoftim vendimi” protokolluar me tonën me nr. 1344/1 prot., datë 1105.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) me nr.199, datë 05.05.2026 “Për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK” në të cilën është vendosur pranimi i ankesës si më poshtë vijon:

“[...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pasi u njoh me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” sh.p.k., lidhur me pretendimin për modifikimin e dokumentave të tenderit “Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i ndërveprimit me e-albania” për Bashkinë Krujë”, me nr. REF-83467-04-27-2026 , ka shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme dokumentacionin e procedurës së prokurimit, Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe analizon si më poshtë vijon:

Së pari, elementi teknik objekt pretendimi i përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht në shtojcën nr.8 (Termat e References) paragrafi i fundit (afati i mirembajtjes) referon se shërbimi objekt kontrate duhet të demonstrohet nga operatori ekonomik fitues brenda 3(diteve) pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore me qëllim vijimin e menjehershëm të shërbimit respektiv pasi sic e theksuam edhe me lart në analizën e këtij vendimi , është shërbim në përbushje të një funksioni publik themelor për Njesitë e Veteqeverisjes Vendore

Termat e references në pergjithësi të publikuara nga ana e AK kanë kuptim të qartë dhe të konsoliduar në legjislacionin shqiptar, nuk përbëjnë nocion të paqartë apo të dykuptimtë.

Mundësia për përbushjen e tyre (termave të references) në rast kontrate hipotetike sipas kërkesave të DST janë thelbësore për vetë AK në përbushjen e detyrimeve institucionale në raport me funksionet e tij por gjithashtu iu kunderdrejtohen edhe operatoreve ekonomik që të jenë të besueshëm dhe profesional pra të kenë pershtatshmerin profesionale e teknike në përbushjen e detyrimeve kontraktuale objekt i procedurës së prokurimit .

Gjithashtu Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pas pretendimit të operatorit ekonomik, konstaton se paragrafi objekt ankimi nga ana e operatorit ekonomik duhet të modifikohet, pjesa që i përket tekstit *Ofertuesi brenda 3 (diteve) nga shpallja e fituesit duhet të demonstrojë pranë drejtorisë së taksave realizimin e funksionalitetëve të kërkuara nga Bashkia....*’, është kërkuar si pasojë e rëndësise themelore që paraqet ky shërbim për ushtrimin e funksionimit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Krujë me qëllim pajisjen në kohë me njoftimin e vlerësimit tatimor ndaj subjekteve (persona fizik ose juridik) që ushtrojnë aktivitet tatimor në Bashkinë Krujë.

Supozimet e operatorit ekonomik ankimues në raport me parashikimin e termave teknik janë të pabaza dhe teresisht qëndrime subjektive, nuk referojnë në elemente të natyrës së procedurës.

Gjithësesi Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit pasi konsultoi në teresi dokumentet e tenderit dhe procedurës respektive (termat e references) si dhe duke u nisuar nga praktika të mëparshme të realizuara nga Autoritetet Kontraktore për procedura të ngjashme, konkludojmë se paragrafi i fundit i termave të references në përbajtje të shtojcës nr.8 të DST së procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i

ndërveprimet me e-albania” për Bashkinë Krujë”, me nr. REF-83467-04-27-2026, duhet te fshihet nga teresia e elementeve te Termave te References .

Me qellim qe vijimi i procedures te jete i qarte dhe transparent per te gjitha palet e perfshira ne procesin e prokurimit publik ne paragrafin e fundit te termave te references se procedures se sipercituar pasazhi qe i perket tekstit *Ofertuesi brenda 3 (diteve) nga shpallja e fituesit duhet te demostroje prane drejtorise se taksave realizimin e funksionaliteteve te kerkuara nga Bashkia....” te hiqet nga ana e Njesise se Prokurimit dhe te integrohet ne modifikimi i termave te references pa kete paragraf ne shtojcen nr.8 si tekst perfundimtar.*

* * *

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se , Njesia e Prokurimit referuar ankimit te subjekti **“Idealdevs Corporation” sh.p.k** duhet te modifikojte termat e references (shtojce nr.8 te DST paragrafin e fundit duke fshire pasazhin... *Ofertuesi brenda 3 (diteve) nga shpallja e fituesit duhet te demostroje prane drejtorise se taksave realizimin e funksionaliteteve te kerkuara nga Bashkia....”*

Në këto kushte në përfundim të arsytimit të mësipërm Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës i caktuar pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë me urdhërin **nr.138 datë 04.05.2025** në mbështetje të nenit 114.3.a të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 102.1.a të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

VENDOSI

a)Të pranoje ankesën e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, **“Idealdevs Corporation” sh.p.k**

b)Njesia e prokurimit te kryeje modifikimin e dokumentave te tenderit (shtojcen nr.8 Termat e Rereferences paragrafin e fundit duke e fshire pazashin... *Ofertuesi brenda 3 (diteve) nga shpallja e fituesit duhet te demostroje prane drejtorise se taksave realizimin e funksionaliteteve te kerkuara nga Bashkia....)*

c)Ky vendim mbahet gjithsej në 4(katër) kopje.

d)Ngarkohen për komunikimin e zbatimin këtij vendimi Personi Përgjegjës për Prokurimin sipas rregullave të Prokurimit Publik.

II.5. Nga verifikimet në SPE rezulton se autoriteti kontraktor bazuar në vendimmarrjen e KSHA e cila ka vendosur pranimin e ankesës nuk ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Me shkresën nr. 3379 prot., datë 06.05.2026 me lëndë: “Njoftim vendimi” protokolluar me tonën me nr. 1344/1 prot., datë 1105.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) me nr.199, datë 05.05.2026 “*Për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK*” në të cilën është vendosur pranimi i ankesës si më poshtë vijon:

“[...]”

* * *

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pasi u njoh me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “**Idealdevs Corporation**” sh.p.k., lidhur me pretendimin për modifikimin e dokumentave të tenderit “**Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i ndërveprimit me e-albania” për Bashkinë Krujë**”, me nr. REF-83467-04-27-2026 , ka shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme dokumentacionin e procedurës së prokurimit, Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe analizon si më poshtë vijon:

Së pari, elementi teknik objekt pretendimi i përcaktuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht në shtojcën nr.8 (Termat e References) paragrafi i fundit (afati i mirembajtjes) referon se shërbimi objekt kontrate duhet të demonstrohet nga operatori ekonomik fitues brenda 3(diteve) pranë Drejtorise se Taksave dhe Tarifave Vendore me qëllim vijimin e menjehershëm të shërbimit respektiv pasi sic e theksuam edhe me lart në analizen e këtij vendimi , është shërbim në permbushje të një funksioni publik themelor për Njesite e Veteqeverisjes Vendore

Termat e references në përgjithësi të publikuara nga ana e AK kanë kuptim të qartë dhe të konsoliduar në legjislacionin shqiptar, nuk përbëjnë nocion të paqartë apo të dykuptimtë.

Mundësia për permbushjen e tyre (termave të references) në rast kontrate hipotetike sipas kërkesave të DST janë thelbësore për vetë AK në permbushjen e detyrimeve institucionale në raport me funksionet e tij por gjithashtu iu kundersdrejtohen edhe operatoreve ekonomik që të jenë të besueshëm dhe profesional pra të kenë pershtatshmerin profesionale e teknike në permbushjen e detyrimeve kontraktuale objekt i procedurës së prokurimit .

Gjithashtu Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pas pretendimit të operatorit ekonomik, konstaton se paragrafi objekt ankimit nga ana e operatorit ekonomik duhet të modifikohet, pjesa që i përket tekstit *Ofertuesi brenda 3 (diteve) nga shpallja e fituesit duhet të demonstrojë pranë drejtorise se taksave realizimin e funksionaliteteve të kërkuara nga Bashkia....*”, është kërkuar si pasojë e rëndësise themelore që paraqet ky shërbim për ushtrimin e funksionimit të Drejtorise se Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Krujë me qëllim pajisjen në kohë me njoftimin e vlerësimit tatimor ndaj subjekteve (persona fizik ose juridik) që ushtrojnë aktivitet tatimor në Bashkinë Krujë.

Supozimet e operatorit ekonomik ankimit në raport me parashikimin e termave teknik janë të pabaza dhe teresisht qëndrime subjektive, nuk referojnë në elemente të natyrës së procedurës.

*Gjithsesi Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit pasi konsultoi në teresi dokumentet e tenderit dhe procedurës respektive (termat e references) si dhe duke u nisur nga praktika të mëparshme të realizuara nga Autoritetet Kontraktore për procedura të ngjashme, konkludojmë se paragrafi i fundit i termave të references në përmbajtje të shtojcës nr.8 të DST së procedurës së prokurimit me objekt “**Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i***

ndërveprimet me e-albania” për Bashkinë Krujë”, me nr. REF-83467-04-27-2026, duhet te fshihet nga teresia e elementeve te Termave te References .

Me qellim qe vijimi i procedures te jete i qarte dhe transparent per te gjitha palet e perfshira ne procesin e prokurimit publik ne paragrafin e fundit te termave te references se procedures se sipercituar pasazhi qe i perket tekstit *Ofertuesi brenda 3 (diteve) nga shpallja e fituesit duhet te demostroje prane drejtorise se taksave realizimin e funksionaliteteve te kerkuara nga Bashkia....” te hiqet nga ana e Njesise se Prokurimit dhe te integrohet ne modifikimi i termave te references pa kete paragraf ne shtojcen nr.8 si tekst perfundimtar.*

* * *

Në përfundim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se , Njesia e Prokurimit referuar ankimit te subjekti **“Idealdevs Corporation” sh.p.k** duhet te modifikojte termat e references (shtojce nr.8 te DST paragrafin e fundit duke fshire pasazhin... *Ofertuesi brenda 3 (diteve) nga shpallja e fituesit duhet te demostroje prane drejtorise se taksave realizimin e funksionaliteteve te kerkuara nga Bashkia....”*

Në këto kushte në përfundim të arsytimit të mësipërm Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës i caktuar pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë me urdhërin **nr.138 datë 04.05.2025** në mbështetje të nenit 114.3.a të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 102.1.a të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

VENDOSI

a)Të pranoje ankesën e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik, **“Idealdevs Corporation” sh.p.k**

b)Njesia e prokurimit te kryeje modifikimin e dokumentave te tenderit (shtojcen nr.8 Termat e Rereferences paragrafin e fundit duke e fshire pazashin... *Ofertuesi brenda 3 (diteve) nga shpallja e fituesit duhet te demostroje prane drejtorise se taksave realizimin e funksionaliteteve te kerkuara nga Bashkia....)*

c)Ky vendim mbahet gjithsej në 4(katër) kopje.

d)Ngarkohen për komunikimin e zbatimin këtij vendimi Personi Përgjegjës për Prokurimin sipas rregullave të Prokurimit Publik.

III.1.1. Nga verifikimet në SPE rezulton se autoriteti kontraktor bazuar në vendimarrjen e KSHA e cila ka vendosur pranimin e ankesës nuk ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit.

III.1.2. Neni 30, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i*

dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se : *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”

III.1.4. Duke qenë, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimes rezultojnë të jenë pranuar nga autoriteti kontraktor, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi por autoriteti kontraktor duhet të publikojë shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin e KSHA nr.199, datë 05.05.2026 “Për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin

e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83467-04-27-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i ndërveprimit me e-albania” për Bashkinë Krujë”, me fondi limit 1,666,000.00 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 08.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje.
 2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën për ndryshimin e dokumentave të tenderit në përputhje me vendimin e KSHA nr.199, datë 05.05.2026 “Për shyrtrimin e ankesës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

